


Rezultatet kryesore të anketës zvicerane
mbi popullsinë aktive

AZPA 2008 shkurtimisht



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Département fédéral de l'intérieur DFI
Office fédéral de la statistique OFS

Neuchâtel, 2009

Falënderojmë veçanërisht familjet
për pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin
e tyre aktiv gjatë AZPA-s.

Botues: Zyra Federale e Statistikës (OFS)

Spektori: 3 Jeta aktive dhe shpërblimi i punës

Shpërndarja: OFS, 2010 Neuchâtel, Tel: 032 713 60 60, Faks: 032 713 60 61

Realizimi dhe plotësimi i informacionit:

Anouk Bläuer-Hermann, Valérie Laessig, Sandra Siegenthaler, Alain Vuille
Spektori Puna dhe jeta aktive, OFS, tél. 032 713 64 00

Gjuha e tekstit origjinal: Frengjisht dhe gjermanisht

Përkthimi: Lindita Telkiu, Gjenevë


Grafikët dhe faqosja: OFS

Ilustrimet: Roland Hirter, Bernë

Ritmi i botimit: Vjetor

Numri i porosisë: 546-0800

Pasqyra e lëndës



| | |
|---|--------------|
| ❖ AZPA: Objektivat dhe temat e parashtruara | 4 |
| – Çfarë është AZPA dhe për çfarë shërben ajo? | |
| – Cilat janë temat e parashtruara ? | |
| ❖ Lidhur me AZPA-n | 5 |
| – Kur dhe si zhvillohet intervista? | |
| – Kush merr pjesë në anketë? | |
| – Lidhur me mbrojtjen e të dhënave? | |
| ❖ Rezultatet kryesore të AZPA 2008 | 6-7 |
| ❖ Personat aktivë të punësuar | 8-9 |
| ❖ Personat pa punë dhe personat në punë të pjesëshme . . | 10-11 |
| ❖ Personat jo aktivë | 12-13 |
| ❖ Disa përkufizime | 14-15 |
| ❖ Për më shumë informacion... | 16 |
| – Botimet | |
| – Pyetje të tjera? | |

AZPA: objektivat dhe temat e Parashtruara



❖ Çfarë është AZPA dhe për çfarë shërben ajo?

AZPA = Anketa Zvicerane mbi Popullsinë Aktive

Që prej vitit 1991, Zyra federale e statistikës (OFS), me kërkesën e Këshillit Federal, bën për çdo vit AZPA-n. Kjo anketë ka për qëllim të japë të dhëna lidhur me botën e punës dhe me jetën profesionale në përgjithësi. Ajo bën gjithashtu të mundur njohjen e kushteve në të cilat jetojnë personat e pa punë, pensionistët, gratë shtëpiake si dhe studentët.

Përveç kësaj, në sajë të zbatimit të përpiktë të përkufizimeve ndërkombëtare, AZPA mundëson llogaritjen e një numri të rëndësishëm të treguesve të tregut të punës që janë të krahasueshëm në shkallë ndërkombëtare.

❖ Cilat janë temat e parashtruara?

- Aktiviteti profesional (aktual ose i kaluar)
- Arsytet e mungesës së aktivitetit (në pension, në shkollim, etj)
- Profesionit i mësuar dhe profesionit i ushtruar
- Kushtet e punës: lloji i orarit, puna e natës, puna në fund jave
- Të ardhurat profesionale, të ardhurat e familjes
- Kërkimi i një pune
- Lëvizshmëria profesionale dhe gjeografike

Modulet tematike plotësuese:

- Formimi fillestar dhe formimi i vazhdueshëm (1999, 2003, 2006)
- Puna e pa paguar (2000, 2004, 2007)
- Emigrimet (2001, 2003, 2008)
- Sigurimi shoqëror (2002, 2005, 2008)
- Pajtueshmëria midis familjes dhe punës (2005)

Lidhur me AZPA-n



❖ Kur dhe si zhvillohet intervista?

AZPA zhvillohet çdo vit gjatë tremujorit të dytë (nga prilli deri në qershor) nga një institut i ngarkuar nga Zyra Federale e Statistikës (LINK- Shërbime të Marketingut).

Një anketues apo një anketuese e këtij instituti kontakton me telefon familjet dhe bën një intervistë për rreth 20 minuta.

❖ Kush merr pjesë në anketë?

Në vend që të pyetet e gjithë popullsia, gjë që do të kushtonte shumë shtrenjtë, AZPA zhvillohet me një grup njerëzish përfaqësues të rreth 48'000 vetave.


Për AZPA-n adresat janë marrë nga numrat private të telefonit të regjistrit të Zyrës federale të Statistikës i cili përmban gjithashtu edhe adresat që nuk figurojnë në librin publik të telefonit. Adresat e marra nga ky regjistër pasqyrojnë kështu të gjithë larminë e kategorive të familjeve që banojnë në Zvicër.

❖ Lidhur me mbrojtjen e të dhënave?

Mbrojtja e të dhënave është e siguar nga ligji mbi statistikën federale dhe nga ligji mbi mbrojtjen e të dhënave. Të gjitha të dhënat trajtohen në mënyrë krejtësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistike.

Shifrat e paraqitura në këtë broshurë janë rezultati i një përgjithësimi të përgjigjeve të dhëna nga 48'000 persona. Kështu, çdo person që ka marrë pjesë në AZPA 2008 përfaqëson mesatarisht rreth 130 persona të popullsisë me banim të përhershëm të moshës 15 vjeç e sipër.

Rezultatet kryesore të AZPA – 2008



❖ Zhvillimi i favorshëm i tregut të punës

Sipas rezultateve të AZPA-s, 4 milion e 229'000 persona janë aktivisht të punësuar në tremujorin e dytë 2008, pra 2,6% më shumë se një vit më parë. Kjo rritje është e dukshme po aq tek femrat (+4,1%; nga 1 milion e 863'000 në 1 milion e 940'000 sa tek meshkujt (+1,3%; nga 2 milion e 259'000 në 2 milion e 289'000).

Ndërmjet tremujorit të dytë 2007 dhe tremujorit të dytë 2008, numri i të papunëve është zvogëluar, duke kaluar nga 156'000 në 147'000 persona (-5,9%). Përqindja e të papunëve ka arritur në 3,4% të popullsisë aktive në 2008 (2007: 3,6%).

❖ Numri i të punësuarve aktivë të huaj gjithnjë në rritje

Ekonomia zvicerane ka nevojë për punëtorë të huaj. Rezultatet e AZPA-s 2008 e vërtetojnë këtë. Numri i të punësuarve aktivë me shtetësi të huaj, në krahasim me vitin e kaluar, është rritur përsëri në mënyrë të dukshme; rritja është prej 51'000 personash ose 5,8%. Në tremujorin e dytë 2008 më shumë se një e pesta e 4 milion e 229'000 banuesve të përhershëm të punësuar aktivë janë me shtetësi të huaj (21,9% ose 927'000 persona).


Përbërja e popullsisë banuese e përhershme prej moshës 15 vjeç e sipër sipas statusit të aktivitetit (persona, në mijë), AZPA 2008

Personat aktivë:

- Të pavarur dhe bashkëpunëtorë
- Rrogëtarë dhe praktikantë
- Persona pa punë

Personat jo aktivë:

- Persona në shkollim
- Gra/ burra shtëpiakë
- Pensionistë, rentierë dhe të tjerë jo aktivë



Sa janë ata ... ?



Statusi i aktivitetit (persona në mijë), AZPA 2008

| | Shuma | Burra | Gra | Zviceranë | Të huaj ¹ |
|--------------------------------------|-------------|-------------|-------------|-------------|----------------------|
| Të pavarur | 588 | 382 | 207 | 517 | 71 |
| Bashkëpunëtorë familjarë | 83 | 33 | 50 | 77 | 6 |
| Rrogëtarë | 3345 | 1750 | 1595 | 2530 | 815 |
| Praktikantë | 213 | 124 | 89 | 177 | 36 |
| Persona pa punë | 147 | 66 | 80 | 85 | 61 |
| Persona në shkollim | 299 | 145 | 154 | 239 | 60 |
| Gra/ burra shtëpiakë | 271 | 10 | 261 | 191 | 80 |
| Pensionistë dhe rentierë | 1333 | 555 | 778 | 1182 | 151 |
| Persona të tjerë jo aktive | 139 | 56 | 82 | 89 | 50 |
| Popullsia nga 15 vjeç e sipër | 6417 | 3122 | 3295 | 5088 | 1329 |

Statusi në tregun e punës (persona në mijë), AZPA 1991, 2005–2008

| | 1991 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 |
|--|------|------|------|------|------|
| Shuma | | | | | |
| Persona 15 vjeç e sipër | 5606 | 6210 | 6266 | 6326 | 6417 |
| <i>Nga të cilët: Të aftë të punësuar</i> | 3768 | 3974 | 4051 | 4122 | 4229 |
| Me kohë të plotë (90–100%) | 2811 | 2715 | 2747 | 2789 | 2824 |
| Me kohë të pjesëshme (0–89%) | 956 | 1259 | 1305 | 1333 | 1405 |
| Pa punë | 68 | 185 | 169 | 156 | 147 |
| Jo aktive | 1770 | 2051 | 2046 | 2048 | 2041 |
| Burra | | | | | |
| Burra 15 vjeç e sipër | 2708 | 3009 | 3039 | 3071 | 3122 |
| <i>Nga të cilët: Të aftë të punësuar</i> | 2163 | 2172 | 2214 | 2259 | 2289 |
| Me kohë të plotë (90–100%) | 1995 | 1934 | 1948 | 1990 | 1995 |
| Me kohë të pjesëshme (0–89%) | 168 | 238 | 266 | 269 | 294 |
| Pa punë | 27 | 88 | 78 | 68 | 66 |
| Jo aktive | 518 | 749 | 747 | 744 | 766 |
| Gra | | | | | |
| Gra 15 vjeç e sipër | 2898 | 3200 | 3227 | 3255 | 3295 |
| <i>Nga të cilët: Të aftë të punësuar</i> | 1605 | 1802 | 1837 | 1863 | 1940 |
| Me kohë të plotë (90–100%) | 816 | 782 | 799 | 799 | 829 |
| Me kohë të pjesëshme (0–89%) | 789 | 1021 | 1039 | 1064 | 1111 |
| Pa punë | 41 | 97 | 91 | 88 | 80 |
| Jo aktive | 1252 | 1301 | 1299 | 1304 | 1275 |

¹ Mbajtës i një leje qëndrimi ose i një leje vendosjeje.

Personat aktivë të punësuar



❖ Femrat kanë më pak funksione drejtuese se meshkujt

Në sajë të përmirësimit të vazhdueshëm të nivelit të formimit, përqindja e femrave të punësuar aktive që ushtrojnë një profesion intelektual apo shkencor është rritur me shpejtësi (në krahasim me 2007 rritja prej 9,8% tek femrat kundrejt 4,8% tek meshkujt). Ndërkohë që 8,5% e burrave të punësuar aktivë (195'000) kanë një funksion drejtues, vetëm 4,4% e femrave të punësuar aktive kanë një funksion të tillë (84'000).


❖ Personat me shtetësi të huaj kanë më shpesh një kontratë pune me afat të përcaktuar

Shumica më e madhe e personave rrogetarë kanë një kontratë pune me afat të papërcaktuar (91,7% në tremujorin e dytë 2008). Personat me shtetësi të huaj që kanë një kontratë pune me afat të përcaktuar janë proporcionalisht më të shumtë se personat me shtetësi zvicerane që kanë një kontratë të tillë. Kjo lloj pune është veçanërisht e dendur tek femrat e huaja (8,5% kundrejt 8,1% tek meshkujt e huaj, 7,0% tek zvicëranët dhe 5,4% tek zvicëranët).

❖ Puna përtej moshës ligjore të pensionit

Në vitin 2008, një person në shtatë i moshës 65 deri 74 vjeç ushtron një aktivitet profesional (93'000). Shumica e tyre ushtrojnë një aktivitet të pavarur ose punojnë në ndërmarrjen që i përket një anëtari të familjes. (60,2%).

Statusi i aktiviteteve sipas grupmoshës (në %), AZPA 2008



Sa janë ata ...?



Personat aktivë të punësuar (në mijë), AZPA 2008


| | Shuma | Burra | Gra | Zviceranë | Të huaj ¹ |
|--|-------------|-------------|-------------|-------------|----------------------|
| Grupmoshat | | | | | |
| 15–24 vjeç | 566 | 293 | 272 | 451 | 115 |
| 25–39 vjeç | 1380 | 745 | 634 | 973 | 407 |
| 40–54 vjeç | 1535 | 827 | 707 | 1222 | 312 |
| 55–64 vjeç | 631 | 353 | 279 | 549 | 82 |
| 65 vjeç e sipër | 117 | 70 | 47 | 106 | 11 |
| Shkalla e shkollimit | | | | | |
| Shkalla e dytë I | 678 | 322 | 356 | 412 | 266 |
| Shkalla e dytë II | 2188 | 1092 | 1096 | 1815 | 373 |
| Shkalla e tretë | 1362 | 875 | 487 | 1075 | 288 |
| Aktivitet në kohë të plotë / të pjesëshme | | | | | |
| Kohë të plotë (>=90%) | 2824 | 1995 | 829 | 2107 | 716 |
| Kohë të pjesëshme I (50–89%) | 758 | 175 | 582 | 634 | 124 |
| Kohë të pjesëshme II (<50%) | 647 | 119 | 529 | 560 | 87 |
| Gjendja në profesion | | | | | |
| Të pavarur | 588 | 382 | 207 | 517 | 71 |
| Bashkëpunëtorë familjarë | 83 | 33 | 50 | 77 | 6 |
| Rrogëtarë anëtarë të drejtorisë | 596 | 411 | 185 | 467 | 130 |
| Rrogëtarë që kryejnë funksionin e shefit | 692 | 437 | 255 | 521 | 170 |
| Rrogëtarë pa funksionin e shefit | 2057 | 902 | 1155 | 1542 | 515 |
| Praktikantë | 213 | 124 | 89 | 177 | 36 |
| Profesionet e ushtruara (ISCO) | | | | | |
| Drejtuës, kuadro të lartë | 280 | 195 | 84 | 215 | 64 |
| Prof. intelektuale dhe shkencore | 792 | 504 | 288 | 633 | 159 |
| Profesione të ndërmjetme | 921 | 394 | 527 | 781 | 140 |
| Punonjës të llojit administrativ | 462 | 139 | 323 | 390 | 72 |
| Personnel i shërbimeve dhe i shitjes | 559 | 176 | 382 | 413 | 145 |
| Bujq | 173 | 120 | 53 | 161 | 12 |
| Zejtare dhe punëtorë | 596 | 513 | 82 | 420 | 175 |
| Shoferë dhe grumbullues | 188 | 150 | 37 | 122 | 66 |
| Punëtorë dhe punonjës të pakualifikuar | 236 | 82 | 153 | 146 | 89 |
| Pa tregues/nuk e di | 24 | 14 | 10 | 20 | 4 |
| Shuma | 4229 | 2289 | 1940 | 3302 | 927 |

Përqindja e aktivëve të punësuar (në përqindje), AZPA 1991, 2005–2008

| | 1991 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 |
|--------------|------|------|------|------|------|
| Shuma | 67,2 | 64,0 | 64,7 | 65,2 | 65,9 |
| Burra | 79,9 | 72,2 | 72,8 | 73,6 | 73,3 |
| Gra | 55,4 | 56,3 | 56,9 | 57,2 | 58,9 |

¹ Mbajtës i një leje qëndrimi ose i një leje vendosjeje.

Personat pa punë dhe personat e nënpunësuar




❖ Përqindja e të papunëve në Zvicër mbetet e ulët në krahasim me të gjitha shtetet e botës

Në krahasim me të gjitha shtetet e botës, Zvicra mbetet një nga vendet më pak të prekur nga papunësia (3,4%). Përqindja e të papunëve në këtë vend është shumë më e ulët se mesatarja europiane (BE – 27: 6,8%). Ndërmjet tremujorit të dytë 2007 dhe tremujorit të dytë 2008, shumë shtete të BE/MESHL kanë pasur një ulje të papunësisë. Polonia, që kishte përqindjen më të lartë në kohën e hyrjes në BE në 2004, ka tani uljen më të rëndësishme të papunësisë (-2,5 deri në 7,1%) dhe renditet sot afër mesatares së vendeve europiane. Kurse në Spanjë përqindja e të papunëve është rritur (+2,4 deri në 10,4%); në tremujorin e dytë 2008 ajo është përqindja më e lartë e Europës.

❖ Volumi i punës shtesë i dëshiruar i korespondon 192'000 vendeve të punës me kohë të plotë

Gjithsejt 421'000 persona nuk kanë pasur fare ose kanë pasur pak punë në tremujorin e dytë 2008, pra 9,6% e popullsisë aktive. Kjo shifër ka qenë në zbritje në këto vitet e fundit (10,5% në tremujorin e dytë 2005). Volumi i punës së munguar për të kënaqur personat pa punë dhe personat në nënpunësim i korespondon rreth 192'000 vendeve të punës me kohë të plotë. 59% e këtij volumi (113'000 vende pune) janë për shkak të papunësisë që vazhdon të rëndojë më shumë se nënpunësimi (79'000 vende pune).

Përqindja e të papunëve në Zvicër dhe në Europë në tremujorin e dytë 2008, AZPA dhe Eurostat



Sa janë ata ...?



Personat pa punë (në mijë) dhe përqindja e të papunëve (në përqindje), AZPA 2008

| | Pa punë | | | Përqindja e të papunëve | | |
|---------------------------------|------------|-----------|-----------|-------------------------|------------|------------|
| | Shuma | Burra | Gra | Shuma | Burra | Gra |
| Grupmoshat | | | | | | |
| 15–24 vjeç | 43 | 21 | 22 | 7,0 | 6,7 | 7,4 |
| 25–39 vjeç | 44 | 17 | 27 | 3,1 | 2,2 | 4,1 |
| 40–54 vjeç | 42 | 19 | 23 | 2,7 | 2,3 | 3,1 |
| 55 vjeç e sipër | 18 | 9 | 8 | 2,3 | 2,2 | 2,5 |
| Kombësia | | | | | | |
| Zviceranë | 85 | 38 | 47 | 2,5 | 2,1 | 2,9 |
| Të huaj ¹ | 61 | 29 | 33 | 6,2 | 4,9 | 8,0 |
| Shkalla e shkollimit | | | | | | |
| Shkalla e dytë I | 44 | 19 | 25 | 6,1 | 5,5 | 6,7 |
| Shkalla e dytë II | 76 | 33 | 43 | 3,4 | 3,0 | 3,7 |
| Shkalla e tretë | 26 | 14 | 12 | 1,9 | 1,6 | 2,4 |
| Pa punë | | | | | | |
| Të regjistruar | 63 | 34 | 30 | – | – | – |
| Të paregjistruar | 83 | 33 | 50 | – | – | – |
| Kohëzgjatja e papunësisë | | | | | | |
| Më pak se një vit | 96 | 48 | 48 | – | – | – |
| Një vit ose më shumë | 50 | 18 | 32 | – | – | – |
| Evolucioni i të papunëve | | | | | | |
| 1991 | 68 | 27 | 41 | 1,8 | 1,2 | 2,5 |
| 2005 | 185 | 88 | 97 | 4,4 | 3,9 | 5,1 |
| 2006 | 169 | 78 | 91 | 4,0 | 3,4 | 4,7 |
| 2007 | 156 | 68 | 88 | 3,6 | 2,9 | 4,5 |
| 2008 | 147 | 66 | 80 | 3,4 | 2,8 | 4,0 |

Personat e nënpunësuar (në mijë) dhe përqindja e të nënpunësuarve (në përqindje), AZPA 2006–2008

| | Personat e nënpunësuar | | | Përqindja e të nënpunësuarve | | |
|-------------|------------------------|-----------|------------|------------------------------|------------|-------------|
| | Shuma | Burra | Gra | Shuma | Burra | Gra |
| 2006 | 259 | 58 | 202 | 6,1 | 2,5 | 10,5 |
| 2007 | 263 | 57 | 206 | 6,2 | 2,5 | 10,6 |
| 2008 | 275 | 54 | 221 | 6,3 | 2,3 | 10,9 |

¹ Mbjatës i një leje qëndrimi ose i një leje vendosjeje.

Personat jo aktivë



❖ Vetëm një pakicë e nënave nuk ushtrojnë një aktivitet profesional

Vetëm 31,7% e nënave me një ose më shumë fëmijë nën 4 vjeç nuk janë aktive profesionalisht. Përqindja e femrave jo aktive, fëmija më i vogël i të cilave është nga 4 deri në 6 vjeç, është akoma më e ulët, pak më shumë se një në katër nëna (26%). Më së fundi ky përpjesëtim zvogëlohet akoma (deri në 16,6%) kur bëhet fjalë për nënat, fëmija më i vogël i të cilave është midis 7 dhe 14 vjeç.


❖ Rritja e popullsisë jo aktive e moshës 65 vjeç e më shumë

Rritja e numrit të personave jo aktivë të moshës 65 vjeç e më shumë (+18'000 deri në 1 milion e 127'000) shpjegohet me plakjen e popullsisë. Që prej fillimit të viteve 1990, përqindja e pensionistëve ka vazhduar të rritet pa pushim: ndërkohë që në vitin 1991 kishte 3,5 persona aktivë të moshës 20 deri 64 vjeç për një person të moshës 65 e më shumë, ky numur në vitin 2008 ka rënë në 3,2 persona.

❖ Përqindja e personave jo aktivë në popullsinë e moshës 15 vjeç e më shumë ndryshon sipas rajoneve

Në Zvicër personat e moshës 15 vjeç e më shumë që nuk ushtrojnë një aktivitet profesional përbëjnë një të tretën e popullsisë (31,8%). Kjo përqindje ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga një rajon në tjetrin: përqindja e personave jo aktivë është veçanërisht e lartë në Tiçino (41,6%) dhe në rajonet lemanike (33,8%). Përqindjet më të ulëta janë në Zyrih (29,5%) dhe në Zvicrën qendrore (29,4%).

Përqindja e personave jo aktivë në popullsinë e moshës 15 vjeç e më shumë sipas rajoneve të mëdha (në %), AZPA 2008



Sa janë ata ...?



Personat jo aktivë (në mijë), AZPA 2008

| | Shuma | Burra | Gra |
|-----------------------------|-------------|------------|-------------|
| Personat jo aktivë | | | |
| Në shkollim | 299 | 145 | 154 |
| Gra/ burra në shtëpi | 271 | 10 | 261 |
| Pensionistë dhe rentierë | 1333 | 555 | 778 |
| Persona të tjerë jo aktivë | 139 | 56 | 82 |
| Grupmoshat | | | |
| 15–24 vjeç | 298 | 147 | 151 |
| 25–39 vjeç | 160 | 28 | 132 |
| 40–54 vjeç | 182 | 41 | 141 |
| 55–64 vjeç | 275 | 97 | 178 |
| 65 vjeç e sipër | 1127 | 453 | 673 |
| Kombësia | | | |
| Zviceranë | 1701 | 634 | 1066 |
| Të huaj ¹ | 340 | 132 | 209 |
| Shkalla e shkollimit | | | |
| Shkalla e dytë I | 741 | 221 | 520 |
| Shkalla e dytë II | 1018 | 379 | 640 |
| Shkalla e tretë | 282 | 166 | 116 |
| Shuma | 2041 | 766 | 1275 |

Personat jo aktivë nga 15 në 64 vjeç (në përqindje), AZPA 2008

| Arsyeja e moskërkimit të punës | Shuma | Burra | Gra |
|--|-------|-------|------|
| Shkollimi | 32,6 | 46,2 | 25,5 |
| Ruajtje e fëmijëve ose kujdesje për të rriturit që kanë nevojë | 14,9 | () | 22,5 |
| Arsye të tjera personale dhe familjare | 14,3 | 2,9 | 20,3 |
| Pension | 15,9 | 20,8 | 13,4 |
| Sëmundje/paafësi e përkohshme për punë | 7,8 | 10,1 | 6,6 |
| Invaliditet i përhershëm | 7,3 | 11,9 | 5,0 |
| Arsye të tjera | 7,1 | 7,9 | 6,8 |


Pjesa e personave jo aktivë në popullsi (në përqindje), AZPA 1991, 2005–2008

| | 1991 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 |
|--------------|------|------|------|------|------|
| Shuma | 31,6 | 33,0 | 32,6 | 32,4 | 31,8 |
| Burra | 19,1 | 24,9 | 24,6 | 24,2 | 24,5 |
| Gra | 43,2 | 40,7 | 40,2 | 40,1 | 38,7 |

¹ Mbajtës i një leje qëndrimi ose i një leje vendosjeje.

Shifrat e nxjerra me llogaritje që bazohen në më pak se 50 intervista janë vendosur në kllapa.

Disa përkufizime



❖ **Popullsia me qëndrim të përhershëm**

Bëjnë pjesë në popullsinë me qëndrim të përhershëm të gjithë personat që banojnë në Zvicër të paktën për gjatë një viti. Popullsia me qëndrim të përhershëm përbëhet nga të gjithë personat me shtetësi zviceriane dhe me banim në Zvicër si dhe personat me shtetësi të huaj që janë mbajtës të një leje vendosjeje, të një leje qëndrimi (këtu përfshihen dhe refugjatët e njohur si të tillë), mbajtësit e një leje qëndrimi të shkurtër që zgjat 12 muaj ose më shumë, si dhe funksionarët ndërkombëtarë, diplomatët dhe anëtarët e familjeve të tyre.

❖ **Personat aktivë të punësuar**

Bëjnë pjesë në personat aktivë të punësuar, personat që i kanë mbushur të paktën 15 vjeç dhe që, gjatë javës së referencës,

- kanë punuar të paktën një orë kundrejt pagesës
- ose që, megjithëse kanë munguar përkohësisht në punë (mungesë për shkak sëmundjeje, pushimi, leje lindjeje, shërbimi ushtarak etj.), kanë pasur një punë të paguar ose të pavarur
- ose që kanë punuar në ndërmarrjen familjare pa u paguar.

❖ **Personat pa punë**

(kërkues të punës sipas normave ndërkombëtare)

Bëjnë pjesë në personat e papunë personat e moshës nga 15 deri në 74 vjeç

- që nuk ishin aktivë të punësuar gjatë javës së referencës
- që kanë kërkuar aktivisht një punë gjatë katër javëve të mëparshme dhe
- që ishin të gatshëm për të punuar.

Për shkak të zbatimit të këtij përkufizimi, numri i të papunëve sipas AZPA-s është i ndryshëm nga numri i të papunëve të regjistruar në zyrat krahinore të punësimit, të botuar nga Sekretariati i Shtetit për ekonominë (SECO).

❖ **Personat aktivë**

Bëjnë pjesë në personat aktivë, personat e punësuar dhe personat e papunë. Personat aktivë përbëjnë ofertën e punës.

❖ **Personat e nënpunësuar**

Bëjnë pjesë në personat në punë të pjesëshme personat aktivë të punësuar

- kohëzgjatja normale e punës e të cilëve nuk e arrin 90% të kohëzgjatjes normale të punës në ndërmarrje dhe
- që do të dëshironin të punonin më shumë
- që janë të gatshëm të fillojnë, në tre muajt e ardhshëm, një punë me një kohëzgjatje më të madhe.

❖ **Personat jo aktivë**

Bëjnë pjesë në personat jo aktivë, personat që nuk bëjnë pjesë as tek personat aktivë të punësuar, as tek personat e pa punë.

❖ **Përkufizimi i përqindjeve**


Përqindja e personave aktivë të punësuar = $\frac{\text{personat aktivë të punësuar}}{\text{popullsia me qëndrim të përhershëm}}$

Përqindja e të papunëve = $\frac{\text{personat pa punë}}{\text{personat aktivë}}$

Përqindja e të nënpunësuarve = $\frac{\text{personat e nënpunësuar}}{\text{personat aktivë}}$

Përqindja e aktivitetit = $\frac{\text{personat aktivë}}{\text{popullsia me qëndrim të përhershëm}}$

Për më shumë informacion...



❖ **Botimet**

Botimi vjetor:

Treguesit e tregut të punës 2008

(Nr. i porosisë 206-0802 në frëngjisht ose 206-0801 në gjermanisht, çmimi 22 franga)

Buletinet e shtypit dhe aktualitetet OFS:

Pajtimi: «Jeta aktive dhe shpërblimi i punës», të gjitha buletinet e shtypit dhe aktualitetet e ZFS në lidhje me statistikat e tregut të punës.

(Nr. i porosisë 0609 në frëngjisht ose 0601 në gjermanisht, çmimi 30 franga në vit).

❖ **Pyetje të tjera?**

Për informacione më të hollësishme, ju mund t'i drejtoheni bashkëpunëtorëve të sektorit Puna dhe jeta aktive (në frëngjisht, në gjermanisht ose në italisht):

Telefon: 032 713 64 00

Faks: 032 713 64 87

E-mail: info.arbeit@bfs.admin.ch

Office fédéral de la statistique

Section Travail et vie active

Espace de l'Europe 10

2010 Neuchâtel

Site Internet: <http://www.espa.bfs.admin.ch>